REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
Nr/Br. 19/17, 21/17
Datë/Datum. 07.03.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH Nr. 19/17
21/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej z. Blerim Dina - Kryetar, z. Goran Milenković - Referues, z.Nuhi Paçarizi - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE ankues "NTG Blendi – Prishtinë dhe OE "NTGI Grafo-Loni- Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me material për shtyp", me nr prok "701/16/109/121", të iniciuar nga AK–së /Qendra Klinike Universitare e Kosovës/, më datën 16.02.2017 mori këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohen,** pjesërisht si të bazuara ankesat e OE "NTG Blendi – Prishtinë dhe OE "NTGI Grafo-Loni" - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me material për shtyp", me nr prok "701/16/109/121", iniciuar nga autoriteti kontraktues /Qendra Klinike Universitare e Kosovës/.

II. **Anulohet,** vendimi për dhënie të kontratës i AK-së /Qendra Klinike Universitare e Kosovës/, për aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me material për shtyp", me nr prok "701/16/109/121 dhe lënda kthehet në **Rivlerësim.**

III. Autoriteti kontraktues në afat prej 10 ditësh, duhet ta informojë me shkrim Panelin shqyrtues, për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe palët tjera në procedurë.

IV. Operatorëve ekonomik ankues "NTG Blendi" – Prishtinë dhe OE "NTGI Grafo-Loni" - Prishtinë, iu kthehet tarifa e sigurimit të ankesës në shumë e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesave, pasi që ankesat janë aprovuar pjesërisht si të bazuara.

V. Obligohen operatorët ekonomik ankues që konform nenit 36 pika 5 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt:16.08.2016.

Hapja e ofertave është bërë me dt:07.09.2016, ku kanë marr pjesë pesë operatorë ekonomik.

Njoftimi për dhënie të kontratës është bërë me dt:05.01.2017, e ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik "Office 1 Kosova" - Prizren.

Kundër njoftimit për dhënie të kontratës, operatori ekonomik" NTGI Grafo-Loni-Prishtinë" me dt:09.01.2017, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Kundër njoftimit për dhënie të kontratës, operatori ekonomik "Blendi"-Prishtinë" me dt:09.01.2017, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Me dt:20.01.2017 autoriteti kontraktues ka marr vendim që të refuzohen kërkesa për rishqyrtim të operatorëve ekonomik.

I pakënaqur me vendimin e autoritetit kontraktues për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim Operatori ekonomik "NTG Blendi- Prishtinë, ka deponuar ankesë në OSHP, më 20 janar 2017 me nr. 19/17, kundër njoftimit për dhënie të kontratës me titull: "Furnizim me material për shtyp", me nr prok: "701/16/109/121", duke pretenduar se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitës së LPP-së nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, me Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, siç janë:

- Neni 7 i LPP-së – Barazia në trajtim/jo Diskriminimi
- Neni 59 i LPP-së –Ekzaminimi, vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
- Neni 60 i LPP-së –Kriteret për dhënie të kontratës

I pakënaqur me vendimin e autoritetit kontraktues për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim Operatori ekonomik "NTGI Grafo Loni - Prishtinë, ka deponuar ankesë në OSHP, më 20 janar 2017 me nr. 21/17, kundër njoftimit për dhënie të kontratës me titull: "Furnizim me material për shtyp", me nr prok: "701/16/109/121", duke pretenduar se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitës së LPP-së nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, me Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, siç janë:

- Neni 6 i LPP-së- Ekonomiciteti dhe efikasiteti
- Neni 7 i LPP-së – Barazia në trajtim/jo Diskriminimi
- Neni 59 i LPP-së –Ekzaminimi, vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
- Neni 60 i LPP-së –Kriteret për dhënie të kontratës

Organi Shqyrtues i Prokurimit, pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 të LPP-së, ka autorizuar ekspertin e OSHP-së, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertja shqyrtuese përmes raportit të datës 10 shkurt 2017, ka menduar që AK-QKUK, për aktivitetin e prokurimit "furnizim me material për shtyp" , me nr të prok:701/16/109/121, nuk ka respektuar në tërësi dispozitat e LPP-së, përkatësisht nenin 59 si dhe nenin 60 të LPP-së. Po ashtu ekspertja shqyrtuese sqaron se me rastin e rivlerësimit AK-QKUK nuk ka respektuar nenin 41.8 i rregullores dhe udhëzuesit operativ, andaj i ka propozuar panelit shqyrtues që aktivitetin e prokurimit ta kthejë në ri-vlerësim, dhe të aprovohen si të bazuara ankesat e OE Ankues.

Operatori ekonomik ankues "NTGI Grafo-Loni" - Prishtinë, me datë: 13 shkurt 2017, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik ankues "NTG Blendi - Prishtinë, me datë: 14 shkurt 2017, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues me datë: 15 shkurt 2017, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 16.02.2017,e cila është mbajtur konform nenit 28 paragrafi 1 pa pranin e palëve ku kanë qenë prezent anëtarët e panelit shqyrtues, eksperti shqyrtues, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë ekspertja shqyrtuese ka deklaruar: "Qëndroj pranë raportit të ekspertizës 10.02.2017".

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Blendi" se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar tri referenca të natyrës së njëjtë të furnizimeve gjatë tri viteve të fundit, paneli shqyrtues konstaton se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar referenca që mjaftueshëm dëshmojnë se ky OE e ka përmbushur substancialisht kërkesën në lidhje me referencat, pasi që në kontratat dhe referencat që ka ofruar ky OE, shihet qartë se furnizimet që i ka bërë janë të natyrës së njëjtë pa marr parasysh emërtimin e kontratës.

Paneli shqyrtues lidhur me pretendimin e OE "Grafo Loni" se AK-QKUK nuk e ka bërë vlerësimin e ofertave sipas nenit 59 të LPP-së si dhe nuk ka vepruar konform nenit 41 pika 8 e Rregullave dhe Udhëzuesit operativ për Prokurim Publik, duke pasur parasysh çmimin total të OE ankues i cili ka qenë në vlerë 43.699.50 €, ndërsa pas përmirësimit ka rezultuar të jetë 42.989.5 € ku diferenca qëndron 710 € atëherë kuptohet që shuma e ndryshimit është brenda 2%. Prandaj ky pretendim i OE ankues është i qëndrueshëm, pasi që nuk po tejkalohet shuma prej dy përqind e gabimeve aritmetike e totalit të ofertës së OE ankues.

Paneli shqyrtues konstaton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Z. Blerim DINA

REPUBLIKA E KOSOVËS ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT TELOZA RAZMATRANJE NABAVKI PRISHTINË REPUBLIKA KOSOVA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – "Qendra Klinike Universitare e Kosovës"

1x1 OE – "NTG Blendi "- Prishtinë

1x1 OE – "NTGI Grafo-Loni"- Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.